

VENDIM
Nr. 787, datë 28.12.2017

**PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJES SË INSPEKTOR ERVIN ROBERT
HAXHIU, ISH-PUNONJËS POLICIE, I CILI KA HUMBUR JETËN
NË KRYE TË DETYRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 130/2016, “Për buxhetin e vitit 2017”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e ndihmës financiare prej 5 000 000 (pesë milionë) lekësh, familjes së inspektor Ervin Robert Haxhiu, ish-punonjës policie në Komisaratin e Policisë nr. 5, Kamzë, në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, i cili ka humbur jetën në krye të detyrës.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.

3. Vendimi nr. 894, datë 21.12.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për dhënie ndihme financiare familjes së inspektor Ervin Robert Haxhiu, ish-punonjës policie, i cili ka humbur jetën në krye të detyrës”, shfuqizohet.

4. Ngarkohet Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama